2442

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUKËS
**DREJTORIA FINANCËS DHE BUXHETIT**

Lënda: Kthim përgjigje të kërkesës për informacion Nr.68 Prot. Datë 15.04.2024

Drejtuar : **Qendra "Res Publica"**
Adresa: Blv „Gjergj Fishta" Nd.24, H.3, Ap.7
Tiranë, Albania

Në përgjigje të kërkesës për informacion Nr.Prot.61/24, Datë 15.04.2024, protokolluar nga ana e Bashkisë Kukës me Nr.68 Prot. Datë 15.04.2024, ju dërgojmë tabelën e planifikimit të Buxhetit të Bashkisë Kukës, parashikuar për artin dhe kulturën për vitet 2022-2023, kjo tabelë përmban të dhëna për informacionin në lidhje me pyetjet e Qendrës "Res Publica";

1. *Sa është buxheti i parashikuar për artin dhe kulturën për vitet 2022-2023?*

*Vlera në lekë*

| Bashkia Kukës | | Buxheti i parashikuar për artin dhe kulturën për vitet 2022-2023 (Qendra kulturore e Bashkisë, Biblioteka e Qytetit dhe Muzeu) | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Vitet | Nr.VKB | 600-Paga | 601-Sigurime shoqërore | 602-Shpenzime operative (Për Aktivitetin Eksod '99, Aktivitet për 1 Qershorin - Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, Aktiviteti i Ditës së Bjeshkëve 11-Korriku, Aktiviteti i festës tradicionale të Gjallicës, Aktiviteti i festës tradicionale të muzave) | 231-Investime kapitale |
| 2022 | 71 datë 24.12.2021 | 12,366,000 | 2,065,000 | 2,800,000 | 0 |
| 2023 | 80 datë 23.12.2022 | 12,411,000 | 2,020,000 | 2,790,000 | 0 |

2. *Sa nga ky buxhet është alokuar?*

Fondet e mësipërme janë nga të ardhurat e Bashkisë Kukës dhe siç shihet në tabelë këto fonde janë miratuar me VKB nr. 71 datë 24.12.2021 dhe VKB 80 datë 23.12.2022.

3. *Kopje të listës së projekteve të financuara në art dhe kulturë nga institucioni për vitet 2022-2023 ku të përfshihen të dhëna lidhur me titullin e projektit, vlerën e financuar, aplikanti përfitues, kohën e realizimit të projektit.*

Gjatë vitit 2022 ka vazhduar financimi për "Aktivitetet ndihmëse për projektin "Parku i Aventurave Shishtavec", me kod projekti G125005 në vlerën 203,633 lekë, si dhe "Shërbim i projektit Teknologjitë emocionale për vlerësimin e trashëgimisë kulturore brenda nëntokës", me kod projekti G125005 në vlerën 4,036,604 lekë. Gjatë vitit 2023 ka vazhduar financimi për Pagese TVSH-je projektet me financim te huaj me kod projekti 90005AD në vlerën 676,586 lekë.

Faleminderit për mirëkuptimin!